



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

Nr. ____ Prot.

Tiranë ____/____/ 2026

**FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIT**

**Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë (BOE) CLIMACASA SHPK &
O.B.KONSTRUKSION SHPK**

*[L07805502F & K93728201A; CLIMACASA 90% & O.B.KONSTRUKSION 10%; Tirane, Rruga e
Kavajës, ekspozite pranë urës Teknologjikut & Durrës, Krujë, Qendër Krujë, Lagjia Nr. 1]*

- OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ **JO** ☒

-OE/BOE me Subjekt Mbështetës:

PO ☐ **JO** ☒

Tipi i Kontratës: Mallra

Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur

Numri i Procedurës / referenca e Lotit: REF-83142-04-23-2026

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Blerje F/V Chillera”**, me fond limit 12,491,394 (dymbëdhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e një mijë e treqind e nëntëdhjetë e katër) lekë pa tvsh, dhe kohezgjatje 30 dite.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 24.04.2026

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletin e Njoftimeve Publike [27 Prill 2026] [29]

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomike më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. COMFORT SHPK

J61901194M

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-t

Vlera 10,420,000 (dhjetë milion e katërqind e njëzet mijë)

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

2. SULOLLARI-KLIMA SHPK

K01529003M

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 11,478,000 (njëmbëdhjetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e tetë mijë) leke pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

3. BOE CLIMACASA SHPK & O.B.KONSTRUKSION SHPK

L07805502F & K93728201A

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 11,545,000 (njëmbëdhjetë milion e pesëqind e dyzet e pesë mijë) leke pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

4. EUROCLIMA SHPK

K71630037L

Emri i plotë i shoqërisë

Numri i NIPT-it

Vlera 12,059,498.81 (dymbëdhjetë milion e pesëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë pikë tetëdhjetë e një) leke pa tvsh

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. COMFORT SHPK

J61901194M

Operatori ekonomik “COMFORT” shpk nuk përmbush kërkesat e pikës 3 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, Kapacitetit Teknik, konkretisht pika 2.3.8 ku percaktohet se: “Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë “Dokumentin e Vlerësimit të Riskut (DVR), në pajtim me Ligjin nr 10237, date 18.02.2010 “Për sigurinë dhe Shendetin në Punë”, I ndryshuar, sipas fushes së objektit të veprimtarisë. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se DVR nuk është e plotë pasi nuk ka firmë dhe vulë nga një subjekt i specializuar për këtë, dhe si rrjedhojë dokumenti konsiderohet i pavlefshëm.

Mangësitë e sipërcituara u konfirmuan nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave. Mbështetur në Nenit 92, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në

përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu X, Neni 82, pika 2: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme....”

2. SULOLLARI-KLIMA SHPK

K01529003M

Operatori ekonomik “SULOLLARI-KLIMA” shpk tek 2.3 Kapaciteti Teknik , pika 1.3.6 Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontratë, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat e leshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, ose ekuivalentet e tyre për objektin e prokurimit si më poshtë.

ISO 9001:2015 (ose e përditësuar) në fushën e menaxhimit të cilësisë, objekti i së cilës të ketë lidhje me objektin e prokurimit; (Skadencia e dokumentit në datën 03.06.2026)

ISO 45001:2018 (ose e përditësuar) për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë; (Skadencia e dokumentit në datën 03.06.2026)

Përsa më sipër, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, vendos të shpall të pavlefshme këtë ofertë, pasi certifikata e mesipërme ISO kanë skadencën që i perfundon në datën 03.06.2026, duke i bërë të pavlefshme lidhur me plotësimin e kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. EUROCLIMA SHPK

K71630037L

Operatori ekonomik “EUROCLIMA” nuk përmbush kërkesat e pikës 2 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, Kapacitetit Teknik, konkretisht pika 2.2.3 ku përcaktohet se:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024, 2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “EUROCLIMA” shpk, ka ngarkuar në sistemin bilancet e viteve 2023, 2024 dhe me firmë dhe vulë nga vete subjekti dhe jo të njehsuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Operatori ekonomik “EUROCLIMA” nuk përmbush kërkesat e pikës 2/b të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit, ku përcaktohet se: “Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik të prokurimit, rezultoi se operatori ekonomik “EUROCLIMA” shpk ka ngarkuar në SPE një Sigurim Oferte pa vulë nga një organ kompetent, si rrjedhojë dokumenti i ngarkuar në SPE konsiderohet i pavlefshëm.

Mangësitë e sipërcituara u konfirmuan nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Mbështetur në Nenin 92, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, si dhe Vendimit të Këshillit të

Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu X, Neni 82, pika 2: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme....”

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*BOE CLIMACASA SHPK & OB KONSTRUKSION SHPK, Tirane, Rruga e Kavajës, ekspozite pranë urës Teknologjikut & Durrës, Krujë, Qendër Krujë, Lagjia Nr. 1*], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 11,545,000 [*njëmbëdhjetë milion e pesëqind e dyzet e pesë mijë*] leke pa tvsh, është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.